



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 13

Prishtinë, më 30.04.2015 ora: 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

Procesverbal

i mbledhjes së komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Xhevahire Izmaqi, Shqipe Pantina, Jelena Bontic dhe Zafir Berisha.

Mungoi: Alma Lama dhe Pal Lekaj.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Mirjeta Heta.

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit e OSCE-se, BIRN, GAP.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 24.04.2015;**
- 3. Hartimi i planit të veprimit për monitorimin e ligjeve, sipas planit të punës së komisionit;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur me 24.04.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Hartimi i planit të veprimit për monitorimin e ligjeve, sipas planit të punës së komisionit;

Zenun Pajaziti – ai tha se sipas planit të punës së Komisionit, kemi caktuar disa ligje për monitorim, të përcaktohen anëtarët në grupe punuese dhe të përcaktohet plani i punës së grupeve punuese. Hapi debat.

Shqipe Pantina – propozoi që fillimisht të monitorohet ligji për gjuhët, dhe të bëhen dy grupe punuese gjatë monitorimit të dy ligjeve, ligjit për OJQ-të dhe ligjit për Administratën Shtetërore.
Sadri Ferati – propozoi që të përcaktohen së paku katër deputet dhe drejtuesit e grupeve punuese dhe shprehu gatishmërinë për të drejtuar grupin punues për ligjin për kufijtë administrativ të komunave.

Xhevahire Izmaku – u pajtua me propozimin e z. Feratit dhe shprehu gatishmërinë për të drejtuar grupin punues për monitorim të ligjit për Administratën Shtetërore.

Zafir Berisha – propozoi që gjatë këtij sesioni pranveror të përcaktohet vetëm një ligj për monitorim dhe në sesionin vjeshtor të vazhdohet me monitorimin e ligjeve tjera.

Shqipe Pantina – propozoi që të monitorohen katër ligje dhe shprehu gatishmërinë për të drejtuar grupin punues për ligjin për OJQ-të.

Jelena Bontic – propozoi që gjatë monitorimit të ligjeve në grupe punuese të bashkëngjiten ekspert të organizatave të cilat mbështesin punën e komisionit.

Zenun Pajaziti – propozoi që të fillohet me:

- Mbjajtjen e tryezës për monitorimin e zbatimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve.
- Monitorimin e zbatimit të Ligjit për kufijtë administrativ të komunave.

Kujtim Paçaku – propozoi që të zbatohet Kushtetuta e Kosovës, ku flitet për implementimin e gjuhëve, në mënyrë që gjuha rome të jetë e zbatueshme në regjionin e Prizrenit si gjuhë tradicionale.

Zenun Pajaziti – propozoi që grupin punues për mbajtjen e tryezës për monitorimin e zbatimit të ligjit për përdorimin e gjuhëve ta udhëheq z. Paçaku dhe grupin punues për monitorimin e ligjit për kufijtë administrativ të komunave ta udhëheq z. Ferati.

Xhevahire Izmaku – kërkoi të shtyhet afati i raportimit rreth monitorimit të ligjeve deri në shtator në mënyrë që të hartohen raportet të vlefshme gjatë monitorimit të ligjeve.

Komisioni formoi grupin punues për monitorimin e Ligjit për kufijtë administrativ të komunave, me këtë përbërje: Sadri Ferati – kryesues i grupit punues, Xhevahire Izma

ku, Zafir Berisha, Shqipe Pantina, Jelena Bontic dhe Pal Lekaj.

Kryesuese e Grupit punues për monitorimin e Ligjit për administratën shtetërore u caktua Xhevahire Izma

ku, ndërsa në grupin punues për monitorimin e zbatimit të Ligjit për OJQ-të kryesuese u caktua Shqipe Pantina, anëtarët e grupeve punuese do të caktohen në mbledhjen e radhës së komisionit.

4. Të ndryshme

Kryetari i komisionit z. Pajaziti i njoftoi deputetët që në mbledhjen e ardhshme, të mërkurën me 13.05.2015, Komisioni do të mbajë takim me Ambasadorin e OSCE-së.

Poashtu, njoftoi anëtarët e Komisionit, me shkresën e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri, për formimin e grupit të punës për shqyrtimin e Projektligjit nr.05/L-27 për Digjitalizimin e transmetimeve radio difuzive tokësore dhe njëherit e fton edhe Komisionin për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media që të caktojë dy (2) anëtarë

për t'iu bashkuar grupit të punës së Komisionit për zhvillim ekonomik, infrastrukture, tregti dhe industri.

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, mori vendim që në grup punues të jenë anëtarët si në vijim: Sadri Ferati, Xhevahire Izmaqu, Shqipe Pantina dhe Jelena Bontic.

Sadri Ferati – propozoi që të vizitohen vendet në rajon në mënyrë që të merren përvojat rreth praktikave të reformës së pushtetit lokal dhe rreth procesit për digjitalizim, sepse ekziston strategjia për digjitalizim, në mënyrë që të hartohet sa më mirë projektligji për digjitalizim.

Shqipe Pantina – propozon që

- të bëhet një rivlerësim i pushtetit lokal sipas planit të Ahtisarit, sa ka qenë efektiv dhe sa është zbatuar;
- të bëhen takime me komisionet përkatëse të Qeverisë së Shqipërisë;
- të shqyrtohet raporti vjetor i RTK-së, dhe të shohet se a janë zbatuar rekomandimet e komisionit për bordin e RTK-së.

Zenun Pajaziti – sa i përket raportit vjetor të RTK-së, nuk e kemi radhitur në rend dite, sepse po e presim edhe raportin e Auditorit Gjeneral, posa të bëhet zyrtar raporti, në mbledhjen e radhës do të diskutohet në komision.

Në mbledhjen e ardhshme të komisionit u vendos që të ftohen Asociacioni i Arkitektëve të Kosovës, në takim me komisionin.

Mbledhja përfundoi në 11:30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Kryetari i Komisionit,
Zenun Pajaziti**
